REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.3938 Prot. Maliq, më 26.06.2026

VENDIM
Nr.90, datë 25.06.2026
"Për emërtimin e "Qendrës Shëndetësore Sheqeras" Oliver Mero dhe për emërtimin e shkollës 9-vjeçare Shqitas "Ali Gjata"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, i ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 germa "b", nenit 25 pika 1, *Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak*", gërma "ll", neni 55 *"Votimi"* pika 2, neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"* gërma "c", Rregullores së Bashkisë Maliq "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve të nderit dhe emërtimit të institucioneve, rrugëve, shesheve dhe objekteve publike'' pasi shqyrtimit të dokumentacionit përkatës nga Komisioni për Dhënien e Titujve të Nderit pranë Drejtorisë dhe vendimit të marrë nga ky Komision në datë 18.06.2026. Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1.Miratimin e emërtimit të Shkollës 9-vjeçare të fshatit Shqitas (Çaushli) me emrin "Ali Gjata", me motivacion:

- **"Për kontributin e shquar në zhvillimin e arsimit, për përkushtimin në luftën kundër analfabetizmit, si dhe për qëndresën ndaj pushtuesve dhe politikave shtypëse të kohës, duke lënë një trashëgimi të vyer në edukimin e brezave";**

2.Miratimin e emërtimit të Qendrës Shëndetësore të fshatit Sheqeras me emrin "Oliver Mero", me motivacion:

- **"Për kontributin e veçantë në fushën e shëndetësisë, për humanizmin, përkushtimin dhe shërbimin ndaj komunitetit ku jetoi dhe ushtroi profesionin, duke vijuar të ndihmojë qytetarët edhe në kohën kur vetë përballej me probleme të rënda shëndetësore";**

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohen Drejtoria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashki si dhe Njësitë Administrative përaktëse.

4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar.

Miratuar me 21 vota
Vota Pro 21
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ